



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-022

Prishtinë, më 21 qershor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 21 QERSHOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Bilall Sherifi, Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 qershor 2011,
2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur 14 qershor 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 14 qershor 2011.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare që do të mbahet më 23 qershor 2011.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 23 qershor 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nisma legjislative,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-123 për shoqëritë tregtare,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për efikasitetin e energjisë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjendjen civile,
10. Shqyrtimi i Planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor,
11. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënëve Personale.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Rekomandimi i Komisioni për Zhvillim Ekonomi, Infrastrukturë, Tregti, Industri për procedimin e Planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit Radio-frekuencor

Kryesia vendosi që Rekomandimi i cekur më lartë të radhitet në rend dite për mbledhjen plenare, më 23 qershor 2011.

3.2 Rekomandimi i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë për procedimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënëve Personale

Kryesia vendosi që Rekomandimi i cekur më lartë të radhitet në rend dite për mbledhjen plenare, më 23 qershor 2011.

3.3 Kërkesa e deputeteve Alma Lama dhe Vjosa Osmani për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

VENDIM

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputeteve të Kuvendit, në Gjermani, prej 29 qershor deri më 3 korrik 2011, në këtë përbërje: Alma Lama dhe Vjosa Osmani.
2. Të gjitha shpenzimet për këtë vizitë për të lartpërmendurat, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Kuvendit.

3.4 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lartë, mori këtë:

VENDIM

1. Miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores së parë të Ministrisë së Financave 2012/01.

2. Kërkesat buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2012, i dërgohen Ministrisë së Financave, që të përfshihen në Projektbuxhetin për vitin 2012.

Të ndryshme:

1. Përfaqësimi politik pozitë - opozitës në komisionet parlamentare të Kuvendit

Kryesia diskutoi lidhur me përfaqësimin joproporcional politik të pozitës dhe të opozitës në përbërjen numerike të deputetëve në komisionet parlamentare. Deputetët që janë të përfaqësuar në më shumë se dy komisione parlamentare, të lirohen nga mbingarkesa. Duhet të bisedohet me kryetarët e grupeve parlamentare për të rregulluar këtë çështje.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:30** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.